

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Besarta Doli dhe me sekretaren juridike Shkendije Halilosmani, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.A. nga fshati R. Komuna e P. për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.56/2016 të dt. 01.08.2016 e parashtruar në gjykatë me datë 08.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me **datë 14.03.2017**, në praninë e përfaqësuesit të PTHGJ, prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarit E.A. si dhe mbrojtësit të tij avokatit H.Sh. nga Gjakova, me autorizim në lëndë, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.A.** nga fshati R. Komuna e P. i biri i B. dhe i Xh. e gjinisë R. i lindur me datë... në P. ka të kryer fakultetin ekonomike, i pa punë, i martuar, atë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse me datë të pa vërtetuar, e gjer me datë 19.02.2014, në lokalin e tij “ V.L.” në fshatin D. Komuna e Gj. me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në mënyrë të pa autorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që në njehsorin elektrik me numër 97401614 ka vendosur shtipalka prej KKK, direkt në ndërpresë 1,0,2, ku ka qen duke i furnizuar shtëpizat – vilat pa matje, duke u lidhur direkt në rrjetin elektrik, me ç rast ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS Distrikti në Gjakovë, me ç rast të dëmtuarës KEDS Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 9.852.30 euro.

-me çka ka kryer veprën penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në kuptim të dispozitës së nenit 2, 3, 4, 7,17 parag. 1, 41, 42 prag. 1, pika 1.2, 49 parag. 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, nenit 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 365 parag. 1 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit i shqiptohet:

D Ë N I M M E K U S H T

Duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 euro (dyqind euro) dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara K. D. Gj. për mes përfaqësuesit të autorizuar, për të realizuar kërkesën e vet juridiko – pasurore, udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30.- €, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me datë 08.08.2016, ka parashtruar aktakuzë PP.nr. 56/2016 të datës 01.08.2016, kundër të akuzuarit E.A. nga fshati R. Komuna e P. për shkak të veprës penale vjedhje e shërbime komunale nga neni 320 të KPRK-së, në kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës.

Me datë 14.03.2017, është mbajtur shqyrtimi fillestar, në të cilën i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për të njëjtën është penduar, shton se në atë kohë kam qenë i angazhuar me vajzën time që e kam pas të sëmure dhe më shumë kam udhëtuar në Shqipëri, mirëpo meqenëse unë i kam pas nën mbikëqyrje ato vila atëherë unë e pranoj fajin dhe i premtom gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, gjithashtu sa i përket dëmit të shkaktuar KEDS e njoftoj gjykatën se unë në atë kohë kam pasur tokën me qira, nga XH.K. për të cilën posedoj edhe kontratën mbi qiranë, e në të cilën tokë kam ndërtuar vilat dhe pastaj të njëjtat vila ia kam shitur po të njëjtit XH.K. me dt. 29.04.2016, me të cilin jemi marr vesh që borxhin ndaj KEDS e merr përsipër i njëjti të cilin borxh do ta paguaj ai dhe për këtë kam deklaruar t përpiluar tek noteri A.S. me nr. LRP.nr. 2030/2017 të dt. 10.03.2017 të cilën ia prezantoj edhe gjykatës.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, pas leximit të aktakuzës dhe deklarimit të akuzuarit se e pranon në tërësi fajësinë, ka theksuar pa vërejtje rreth pranimit të fajësisë, pasi i njëjti kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije të plotë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në aktakuzë e cila është objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar pa vërejtje rreth pranimit të fajësisë, gjithashtu ne parashtrojmë kërkesë pasurore – juridike të cilën do ta realizojmë në kontest civil.

Meqenëse i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, gjykata ka vërtetuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 paragraf 1, pikat 1.1., 1.2 dhe 1.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht vlerësoj se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim i fajësisë është bërë në baza vullnetare dhe se ka mbështetje edhe në faktet dhe provat që përmban aktakuza. Poashtu ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hedhjen e aktakuzës apo të pushimit të procedurës penale të parapara me nenin 253 paragraf 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur jo vetëm nga pranimi i fajësisë që është bërë nga i akuzuari, por ky pranim ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në kalibrim me nr. 0804863 të dt. 19.02.2014, procesverbali i ndërrimit të njehsorit elektrik me nr. 97401614, fatura mbi dëmin e shkaktuar me nr. DGJ 14HPO3660 të dt. 13.03.2014 të lëshuar nga sektori i faturimit KEK Divizioni i Furnizimit i në Gjakovë, fotodokumentacioni, si dhe shkresat tjera në lëndë.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet – tiparet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të Ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 73 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti pranimin e fajësisë dhe pendimin e tij, qëndrimi e tij korrekt gjatë gjykimit, pasi që i njëjti i është përgjigjur ftesës së gjykatës, paraqitet për herë të parë para gjykatës, pasi që më parë nuk ka qenë i dënuar dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryen vepra tjera penale, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese të cilat kishin për të ndikuar që t'i shqiptohet ndonjë dënim më i rëndë, Gjykata nuk gjeti rrethana të tilla.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se shqiptimi i dënimit me gjobë në shumë prej 200 euro dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 90 ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të tij, rrethanat personale të akuzuarit, si dhe me këtë dënim dot arrihet qëllimi i tij i paraparë në nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontesti civil u murr konform nenit 463 paragraf 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, pasi që i akuzuari gjykatës ia prezantoi deklaratën noteriale të dt. 10.03.2017 me nr. LRP.nr.2030/2017, ku vërtetohet se XH.K. si pronarë tani i shtëpizave " V.L. " ka marr për obligim pagesën e borxhit të KEDS në shumë prej 9.852.30 euro.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPPK-së.

Pas shpalljes së këtij Aktgjykimi, palët udhëzohen për të drejtën në ankesë dhe detyrimin e tyre për njoftimin e gjykatës për çdo ndërrim të vendbanimit deri në përfundim të kësaj çështje penale dhe pasojat që mund të rrjedhin nga kjo në përputhje me nenin 368 paragraf 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 459/2016 të datës 14.03.2017

Sekretarja juridike
Shkendije Halilosmani

Gj y q t a r j a
Besarta Doli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, Departamentit për të mitur në afat prej **15 ditëve** nga dita e pranimit të njëjtit, përmes kësaj Gjykate.